



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 391/1 prot.

Tiranë, më 16.02.2026

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8391,
datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, të ndryshuar”

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 97/2 prot., datë 03.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 391 prot., datë 06.02.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, të ndryshuar” (në vijim “projektligji”), si dhe relacionin shoqërues.

Fillimisht, duke marrë në konsideratë natyrën dhe objektin e veprimtarisë së Shërbimit Informativ të Shtetit (në vijim “SHISH”), vlerësojmë se ushtrimi i detyrave ligjore sipas legjislacionit specifik kërkon edhe garantimin e një balance të qëndrueshme gjatë përpunimit të të dhënave ndërmjet Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “LMDP”) dhe zbatimit të plotë të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Për këtë arsye, pas shqyrtimit të materialeve të dërguara, propozojmë që gjatë finalizimit të projektligjit të merren në konsideratë sugjerimet e mëposhtme.

Përfundimisht, si Autoritet Publik i Shërbimit Informativ të Shtetit nga zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga LDI, nuk rezultojnë në harmoni me kuadrin ligjor në fuqi dhe me detyrimet që burojnë nga Konventa e Tromsø-s, e cila, si akt ndërkombëtar i ratifikuar, gëzon epërsi mbi legjislacionin e brendshëm.

Në këtë kuptim, vlerësojmë se autoritetet e inteligjencës nuk mund të përjashtohen në mënyrë të përgjithshme dhe absolute nga e drejta e informimit, pasi vetë Konventa parashikon se kufizimet e aksesit lejohen vetëm në raste të caktuara, kur ekziston një rrezik

real dhe i provueshëm për sigurinë kombëtare, veprimtarinë e inteligjencës, mbrojtjen e burimeve dhe metodave, informacionin e klasifikuar apo marrëdhëniet ndërkombëtare.

Këto kufizime duhet të aplikohen rast pas rasti, të interpretohen në mënyrë të ngushtë dhe të jenë proporcionale me interesin që synojnë të mbrojnë, duke ruajtur gjithashtu mbikëqyrjen e pavarur nga mekanizma të mëtejshëm kontrolli. Po ashtu, kuadri ligjor parashikon mundësinë e aksesit të pjesshëm dhe detyrimin për transparencë proaktive, sipas nenit 7 të ligjit të sipërcituar, në mënyrë që publiku të informohet mbi funksionimin dhe aktivitetin e përgjithshëm të autoritetit, pa cenuar interesat e mbrojtura me ligj.

Për sa më sipër, sugjerojmë që pika 1 e nenit 5 e projektligjit, të riformulohet si më poshtë:

- *1. E drejta e aksesit mund të kufizohet vetëm kur dhënia e informacionit rrezikon sigurinë kombëtare, veprimtarinë e inteligjencës, mbrojtjen e burimeve dhe metodave, informacionin e klasifikuar ose marrëdhëniet ndërkombëtare, në mënyrë proporcionale dhe me mundësi shqyrtimi nga autoritetet kompetente.*
- *2. Autoriteti siguron transparencë proaktive sipas Nenit 7 të LDI, duke publikuar informacionin mbi organizimin, funksionimin dhe aktivitetet e përgjithshme, për aq sa nuk cenon kufizimet e mësipërme.*

Në nenin 6 të projektligjit parashikohet shtimi i një paragrafi në nenin 13 të ligjit në fuqi, mbi aksesin e SHISH në rolin e lexuesit, në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe përcaktohet se rregullimi i aksesit në to, do të realizohet me marrëveshje të përbashkëta me institucionet përkatëse që do të ndërveprohet.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, aksesin/ndërveprimin e SHISH me bazat e të dhënave shtetërore, për qëllime të garantimit të sigurisë kombëtare, është i ligjshëm në masën që parashikohet shprehimisht në legjislacionin specifik në fuqi, por në çdo rast, përpunimi duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret e përpunimit të të dhënave personale, të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të LMDP.

Për këtë qëllim, sugjerojmë që, në nenin 6 të projektligjit, të shtohet një fjali me këtë përmbajtje: *“Çdo veprim përpunimi i të dhënave personale gjatë aksesit/ndërveprimit me bazat e të dhënave shtetërore, realizohet në përputhje me legjislacionin specifik dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson t’ju sjellë në vëmendje që, gjatë hartimit të marrëveshjeve të përbashkëta për përcaktimin e rregullave të aksesit, të identifikohen në mënyrë konkrete kategoritë e të dhënave personale që do të shkëmbehen dhe përpunohen për përmbushjen e detyrimeve ligjore, gjatë ndërveprimit me bazat e të dhënave të palëve të treta, duke u bazuar edhe në parashikimet e legjislacioneve respektive të institucioneve përgjegjëse që administrojnë këto sisteme. Këto përcaktime duhet të realizohen në harmoni

me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin dhe parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 6 të LMDP, sipas të cilave të dhënat personale mblidhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, si dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

Për sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi